



Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 2 nën pikën c) dhe nenit 40. Paragrafi 40.2 nën a) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, nenit 10 nën pikën 3) të Statutit të Komunës së Klinës, me kërkesën e Drejtorit të Shërbimeve Publike dhe Emergjente, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VI-të radhës për vitin 2018, të mbajtur më 29.06.2018, mori këtë:

V E N D I M

Për vënie në Diskutim Publik të Draft- Rregullores për kushtet dhe mënyrën e bllokimit dhe zhvendosjes së automjeteve në Komunën e Klinës

I

Miratohet vendimi për vënien në diskutim publik të Projekt-Rregullores për kushtet dhe mënyrën e bllokimit dhe zhvendosjes së automjeteve në Komunën e Klinës.

II

Vënia në Diskutim publik e kësaj Projekt-Rregulloreje bëhet me qëllimin e dhënies së kontributit nga institucionet, qytetarët dhe ekspertët e fushës përkatëse, në mënyrë që e njëjta të jetë sa më funksionale nga subjektet implementues dhe të tjerët.

III

Vendimi është i plotfuqishëm që nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës dhe 15 ditë pas protokollimit në MAPL në bazë të nenit 81 të LVL dhe nenit 16 dhe 17 të Rregullores së MAPL- së nr. 01/2017-Per Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunave.

Vendimi është transparent përmes: Tabelës së shpalljeve dhe Zyrës për Informim .

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01 Nr. 06-4725 /2018
Klinë, më 04.07 /2018

